



Pranimi / Datedura Prilimi/Pratato Received/Deputy		03.05.2023	3	viti god year
Organ /Rjeshtja Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printed Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSICK	4020/2023		114	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.452/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-Anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.452/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 02.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.452/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Udhëheqëse e sektorit të Shëndetësisë" në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112-118526 të datës 08.08.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2256/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Vendimit të Menaxherit të Njësisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me numër Nr.01-112/02-0021325/23 i datës 10.02.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.03.2023 me numër protokolli 2976/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa Këshilli përmes e-

mailit më datë 05.04.2023 me numër protokoll 3318/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prizrenit, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokoll 2256/2023 të datës 03.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me numër Nr. 01-112/02-0021325/23 i datës 10.02.2023; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë me numër reference RN00010154 i datës 12.10.2022; Aplikacioni i M.B.S. i datës 03.11.2022; Akt Emërim i M.B.S. me numër AE.Nr.01-112-164327 i datës 21.11.2022; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit i datës 18.11.2022; Njoftim i datës 18.11.2022; Njoftim nga Simbnj për M.B.S. i datës 18.11.2022; Njoftim nga Simbnj për M.B.S. i datës 04.11.2022; Vërtetim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me Nr.02-113-79300 i datës 02.11.2022; Akt Emërim me numër AE.Nr.01-112-118526 i datës 08.08.2022; Diplomë nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren për M.B. me numër Nr.79 i datës 16.01.2015; Diplomë nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren për M.B. me numër Nr.26 i datës 15.04.2019; Vendim me numër protokoll 103/22 i datës 09.03.2022; Vendim nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren me numër protokoll 28/20 i datës 27.01.2020; Certifikatë nga ECMI Kosovo për M.B. i datës 08.12.2014; Certifikatë nga ECMI Kosovo për M.B. e muajit Dhjetor 2016; Certifikatë nga ECMI Kosovo për M.B. e muajit Nëntor 2015; Certifikatë trajnim profesional nga komuna e Prizrenit për M.B. e muajit Dhjetor 2015; Certifikatë nga ECD për M.B. i datës 04.04.2019; Certifikatë nga IKAP për M.B. i datës 06.05.2016; Certifikatë nga IKAP për M.B. i datës 22.09.2015; Certifikatë nga IKAP për M.B. i datës 25.03.2016; Mirënjohje nga MAP për M.B. e muajit Qershor 2016; Certifikatë nga IKAP për M.B.S. i datës 08.11.2019; Certifikatë nga IKAP për M.B. i datës 18.11.2016; Certifikatë për M.B. 08.06.2013; Letërnjoftim i M.B.S.; Autorizim nga M.B.S. për Avokat H.S.i datës 23.02.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 2976/2023 i datës 24.03.2023; E-mail nga I.G. për C.Z. i datës 05.04.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 04.04.2023; Akt Emërim i M.B.i datës 19.08.2014; Formulari i planit individual të personelit (FPIP) viti 2022; Vendim me numër Nr.RAN0008904 i datës 04.11.2022; Akt Emërim i G.G. i datës 02.06.2015; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës i G.G. me numër Nr.112 i datës 07.01.1991; Vendim me numër VK/2023 me numër protokoll 3636/2023 i datës 18.04.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.452/2023 i datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112-118526 të datës 08.08.2022 është e punësuar në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë" në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit.

Ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me pretendimin ankimor kundër Vendimit të Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me numër Nr. 01-112/02-0021325/23 i datës 10.02.2023 me arsyetimin se i njëjti karakterizohet me shkelje ligjore materiale dhe procedurale

dhe kërkon që i njëjti të anulohet dhe të mbetet në fuqi Akt Emërimi AE.Nr.01-112-164327 i datës 21.11.2022 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankueses, ka konstatuar se lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i sektorit për teknologji Informative" e shpallur përmes konkursit të datës 12.10.2022 nga Komuna e Prizrenit për të njëjtën Këshilli ka vendosur meritorisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 18.11.2022 përmes emailit [ankesa.kpmslhck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmslhck@rks-gov.net) ka pranuar ankesën e ankuesit Gëzim Gergi me numër protokolli 7217/2022 të regjistruar në shenjën A.nr.1027/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 14.11.2022. Ndërsa Këshilli me Vendimin me numër A.nr.1027/2022 të datës 18.01.2023 me numër protokolli 492/2023 ka shqyrtuar ankesën e ankuesit Gëzim Gërgi dhe të njëjtën ka Aprovuar si të bazuar ndërsa në pikën II të vendimit shfuqizohet Njoftimi Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit i datës 18.11.2022 për kandidatin e suksesshëm, ndërsa Anulohet procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i sektorit për teknologji Informative" e shpallur përmes konkursit të datës 12.10.2022 nga Komuna e Prizrenit se dhe çdo akt tjetër që rrjedh nga kjo procedurë.

Bazuar në këtë Kolegji konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur për procedurën e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i sektorit për teknologji Informative" e shpallur përmes konkursit të datës 12.10.2022 nga Komuna e Prizrenit, atëherë ankesa e ankueses rrjedhimisht është e konsumuar pasi që Këshilli ka vendos sipas Vendimit me numër A.nr.1027/2022 të datës 18.01.2023 me numër protokolli 492/2023, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankuesit komfor dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike**". Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.452/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.452/2023

Çlirim ZEKA  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

